



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИСЕ СЕ

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 97-të të mbajtur më 27.12.2023, ka miratuar sa vijon,

## VENDIM

Procedura në lëndën me numër 12-3561/1 datë 11.04.2022, e formuar pas denoncimit të personit zyrtar ///, inspektor i punës pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës /// dhe ndaj zyrtarëve të tjerë të punësuar në Inspektoratin Shtetëror të Punës ///, NDËRPRITET.

KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme lidhur me rastin – procedura është duke u zhvilluar pranë organeve tjera kompetente për rastin në fjalë.

Lënda me numër 12-3561/1 nga 11.04.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 11.04.2022, një parashtrues i panjohur ka bërë denoncim kundër personit zyrtar ///, inspektorit i punës pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës /// dhe kundër zyrtarëve të tjerë të punësuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës /// dhe është konstatuar rasti me numër 12 - 3561/1 datë 11.04.2022.

Sipas asaj që është paraqitur në aplikim, personi ///, inspektor pune pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës ///, punon prej disa vitesh si profesor universiteti me angazhim në dy fakultete në /// mësimdhënie në gjuhën shqipe dhe atë në kundërshtim me Ligjin për marrëdhëniet e punës, sepse këtë punë e kryen gjatë orarit të punës si inspektor dhe pa marrë pëlqimin për punë shtesë.

Gjithashtu, në raport thuhet se dy zyrtarë arkivistë nga Inspektorati Shtetëror i Punës ///, gjatë orarit të punës, mungojnë në mënyrë të pajustificueshme në punë për të ndjekur ligjëratat universitare si studentë, për çka parashtruesi dyshon se nuk po kryejnë punën dhe detyrat e tyre të punës dhe detyrimet dhe se janë të punësuar vetëm formalisht në Inspektoratin Shtetëror të Punës ///.

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија  
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: [contact@dksk.org.mk](mailto:contact@dksk.org.mk)

тел/tel: +389 2 3248 930

<http://www.dksk.mk>

Me q llim t  verifikimit t  pretendimeve nga denoncimi dhe p rcaktimit t  gjendjes faktike n  rastin e denoncuar, KSHPK-ja i ka dor zuar K shillit Inspektues nj  k rkes  p r trajtimin dhe dh nien e t  dh nave dhe informacioneve.

Nga k qyrja e t  dh nave, informacionit dhe dokumentacionit t  dor zuar me k rkes  t  KSHPK-s ,  sht  konstatuar kjo gjendje faktike:

K shilli i Inspektimit ka nxjerr  nj  urdh r me t  cilin Inspektorati Shtet ror i Pun s dhe Inspektorati Shtet ror i Arsimit ngarkohen p r kryerjen e nj  inspektimi t  jasht zakonsh m t  p rbashk t. N  p rgjigjen e dor zuar n  KSHPK, K shilli i Inspektimit thekson se me marrjen e t  dh nave nga inspektoratet p rgjegj se do t  informoj  shtes  KSHPK-n  p r kushtet e konstatuara.

Nga sa u tha m  lart , rezulton se organet kompetente jan  duke vepruar dhe jan  t  obliguara t  nd rmarrin masat e duhura n  pajtim me Ligjin p r Mbik qyrjen Inspektuese.

Duke marr  parasysh sa m  sip r, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente p r veprime t  m tejshme lidhur me k t   shtje dhe vendosi si n  dispozitiv t  k tij vendimi.

P rgatiti: A.R.M.

Miratoi: N.B, an tar i KSHPK-s 

**KOMISIONI SHTET OR  
P R PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
N nkryetar,  
Sofka Pejovska Doj inovska**